



# INFORMATIKA



[www.shmk-negotine.edu.mk](http://www.shmk-negotine.edu.mk)

# HARDUERI / ANG. HARDWARE

Kompjuterët bashkëkohor

Arkitektura kompjuterike

Hardueri

Njësia qendrore

Procesori

Pllaka amë

Magjistralet

Memoria e brendëshme

Memoria e jashtme

Njësitë hyrëse

Njësitë dalëse

- Njësitë hyrëse – dalëse
- Bit
- Bajt
- Konfigurimi
- Teknologjia e bazuar në prekje
- Teknologjia pa prekje
- 3D teknologjia
- Holografia
- Teknologjia heliodispleje

# NDARJA E KOMPJUTEREVE BASHKEKOHORE

*Sot kompjuteret paraqesin mjet per punen e perditshme, per argetim dhe per komunikim dhe jane pjese e numrit te madh te makinave, psh: bankomate, automobila, aparate per amviseri etj...*

Kompjuteri: eshte pajisje elektronike tek i cili mund te jepen instruksione per pranim, perpunim, per ruajtje, per te paraqitur te dhena dhe informata.

Ndarja e kompjutereve sipas madhesisë:

- 1) SUPERKOMPJUTERE
- 2) KOMPJUTERE TE MEDHENJ (mainframe)
- 3) MINIKOMPJUTERE dhe  
MIKROKOMPJUTERE (kompjuteret personal)

# SUPERKOMPJUTERET

Superkompjuteret janë me të shpejtet, me të fuqishimit dhe me të shtrejtet. Ata janë të mdhenje, kanë numër të madh të procesoreve dhe kapacitet të madh të hardisqeve.

Zbatimi: për qëllime ushtarake, shkencore, por sot me aktuale është simulimi i termeteve, uraganeve, thatesires, vershimeve, klima globale etj...

Gjithashtu kompanitë që meren me prodhimin e aeroplanëve dhe autobusëve bëjnë testimin në kushte të ndryshme të tyre me shfrytëzimin simulimeve me ndihmën e superkompjuterëve.

Gjithashtu shërbejnë për numër të madh të konsumatorëve.



# MINIKOMPJUTERET

Minikompjuteret janë shume te vegjel dhe shume te lire prej kompjutereve te medhenj. Keta kompjutere punojne me disa procesore dhe mund te mbajne 4-200 konsumatore ne te njejten kohe.



# MIKROKOMPJUTERET (PC)

Mikrokompjuteret ose kompjuteret personal (PC) relativisht te lire te dedikuar per pune te nje konsumatori te cilet jane shume te kufizuar me kompjuteret e lartepemendur. Keta kompjutere permbajne nje processor, jane shume me te ngadalshem, mund ti perdor vetem nje konsumatore ne kohe te caktuar, mund te ruajne dhe perpunojne shume me pak sasi te te dhenave. Andaj perdoren ne kompani te vogla dhe perdorim shtepiak.

Por me zhvillimin e teknologjise mikrokompjuteret fitojne performanca te fuqishme dhe sot kane mundesi te punojne jo vetem sikurse klient, por edhe si server.



# DISA KOMPJUTER PERSONAL (PC)

Kompjuteret personal (PC) mund te jene statik (desktop) dhe personal (notebook, tablet, palm, PDA, iphone, etj...).





# KOMPJUTERI STATIK DHE PERSONAL

Kompjuteri statik eshte dizajnuar ashtu qe pjeset e tij themelore (shtepiza, tastiera, miu dhe monitori) jane te ndare dhe mund te vendosen mbi tavoline. Shtepiza mund te jete e vendosur horizontalisht dhe vertikalisht dhe tek ajo bashkangjiten pjeset tjera nepermjet portave. Pjesa me e madhe e portave gjenden ne pjesen e prapme te shtepizes. Kohen e fundit jane te zhvilluara portat universal (USB) nepermjet te cilave mund te bashkangjiten pajisje tjera periferike.

Kompjuteri personal te gjitha pjeset i ka te integruara ne teresi dhe mungesa me e madhe ketyre kompjutereve eshte ajo qe nuk mund te permiresohen. Disa pajisje mund te bashkangjiten nepermes portave. Kompjuteri bartes permban edhe bateri per pune te pavarur.



*Kompjuteri statik*




*Laptop dhe notebook kompjuteri*



# PORTAT E PC STATIK DHE LAPTOP



# SKEMA E NDARJES



# KOMPJUTERET E FOLEZUAR

Pervec llojeve te kompjutereve egzistojne edhe kompjuter te cilet ndertohen ne makina tjera ose te pjeset e tyre, e ashtuquajtur kompjuter te folezuar. Per dallim nga kompjuteret tjere, kompjuteret e folezuar nuk kane monitor dhe tastiere dhe nuk punojne ne menyre te pavarur.

Ata kane program i cili nuk mund te ndryshoje dhe jane te dedikuar te kryejne vetem nje pune specifike, psh., kontrolli i temperatures dhe lageshtise, kontrolli i punes se zemres.

Kompjuteret e folezuar jane ndertuar na pajisje sic jane: fotoaparartet digjitale, telefonat mobil, player muzikor, furra mikrovale etj...



# PYETJE

